

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR “MASHAEL TRAVEL AND
TOURS” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “MASHAEL TRAVEL AND TOURS” Sh.p.k.

- 1- **MIMOZA MURATI** atesia **PELLUMB** shtetas SHQIPTARE,
lindur me 16.04.1987 ne SKRAPAR , identifikohet nepermjet
pasaportes BF 1647884.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “MASHAEL TRAVEL AND TOURS” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “MASHAEL TRAVEL AND TOURS” Sh.p.k.,

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**


Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “BRIGADA 8” pallati 23, hyrja 4, kati 10 , ap 42, Tirane, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

1

AKT THEMELIMI “ MASHAEL TRAVEL AND TOURS” SHPK



NENI 4
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**MASHAEL TRAVEL AND TOURS**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive ne Republiken e Shqiperise dhe ne territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimitarise së saj:

Agjensi turistike:1.Ushtimi i aktiviteteve ne fushen e turizmit dhe te udhetimeve e transportit turistik. 2. Organizimin e udhetimeve dhe pushimeve individuale ose kolektive per shtetasit shqiptar dhe te huaj brenda dhe jashte vendit dhe ndermjetesimin per shitjen e produkteve turistike ne te gjitha format e tij. 3. Sherbime qe mund te ofrohen ne rastin e udhetimeve dhe pushimeve si:Rezervimi vendeve te fjetjes ne njesite akomoduese turistike si hotele, vila etj. Rezervimi dhe shitja e biletave per linjat ajrore dhe detare etj. Rezervimi i vendeve, mjeteve te transportit turistik. Venja ne dispozicion me qera pjesore ose totale e ketyre mjeteve. Porositja e ushqimit ne restorante turistike. 4. Organizimi i vizitave ne qytete, muze, monumente historike-kulturore, natyre etj.brenda dhe jashte vendit 5. Sherbime guide dhe i perkthyesve etj. 6. Dhenia e informacioneve per turizem, udhetime, objekte socialkulturore etj. 7. Ndermjetesim me shitesit kryesore ne produktet turistik. 8. Dhenia e atomjeteve te ndryshme me qera ditore, mujore apo vjetore etj9. Rezervimi dhe preje te biletave per transportin ajror , rrugor dhe detar me te cilat do te udhetojne. Ndjekje e dokumentacionit te nevojshem per te gjithë proceduarat e vizave turistike per te hujat brenda dhe jashte vendit.

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.



NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndare në 1 pjese.Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1. MIMOZA MURATI **100,00%**

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7
AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i

tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8
ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “MASHAEL TRAVEL AND TOURS” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emëruar **EVA QOKAJ**.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

AKT THEMELIMI “ MASHAEL TRAVEL AND TOURS” SHPK



Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 20/08/2020

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“MASHAEL TRAVEL AND TOURS” SH.P.K.**

MIMOZA MURATI

